



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 24.8.2023

Nr: 729

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**“NGRITJEN DHE THIRRJEN E MBLEDHJES SË PARË TË KOMISIONIT TË ZONËS SË
ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR. 11, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË
KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronjat “b” dhe “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Ngritjen e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023.
2. Mbledhja e parë e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, do të zhvillohet në selinë e KZAZ-së, njësia administrative Kukës, Pallati i Kulturës “Hasan Prishtina”, kati i dytë, në datën 25 gusht 2023, ora 10:00
3. Bashkia Kukës do të sigurojë infrastrukturën logjistike në selinë e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 24.8.2023 Nr: 729
Ora: 12:00



“Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24.9.2023”